

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-60/12

Prishtinë, 24 gusht 2012

Në çështjen juridike të:

**D. Z.**

*Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese*

Kundër

**M. K.**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/131/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA08620), të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 24 gusht 2012, mori këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Anullohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/131/2011, i datës 26 tetor 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA08260 dhe hedhet poshtë kërkesë e D. Z. pasi që ajo nuk është në juridiksionit të AKP-së.
- 2- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 22 janar 2007, D. Z. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronar i banesës prej 72,28 metrave katror, që gjendet në katin e parë të një ndërtese të ndërtuar në vitin 1998 në Prizren, 2E në rrugën “Revolucioni i tetorit”. Ai ka pohuar se është pronar i banesës në bazë të kontratës së shitblerjes të datës 23 mars 1999 dhe se prona e tij ishte uzurpuar. Ai pretendon se e kishte humbur posedimin e pronës me 1 gusht 1999:

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur dokumentet në vijim:

- Vendimin e komisionit banesor të IFS Progresi Prizren, të datës 2 mars 1999;
- Kontratën për shitblerjen e pronës, të lidhur ndërmjet kompanisë së njëjtë si shitës dhe paraqitësit të kërkesës si blerës, të datës 08 mars 1999.

Njoftimi i pronës është bërë me 7 nëntor 2007. Pastaj është paraqitur përgjigja e M. K.. Ajo ka pohuar se i ishte dhënë e drejta e shfrytëzimit të pronës nga pronari legjitim – IFS Progresi Prizren. Pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka paraqitur ndonjë provë në lidhje me këtë.

E njëjta pronë (banesë) ka qenë lëndë e procedurës pranë Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore – vendimi grupor HPCC/D/204/2005/C, i datës 18 qershor 2005 (pikat 12 dhe 14 të argumenteve janë të ndërlidhura) dhe vendimi i rishqyrtimit - HPCC/REC/66/2006, i datës 15/07/2006 (para 50 është i ndërlidhur).

Në atë procedurë, babai i paraqitësit të kërkesës – V. Z. ishte paraqitës i kërkesës. KKPB-ja ka pranuar se paraqitësi i kërkesës V. Z. nuk ka dëshmuar se ka pasur ndonjëherë posedimin mbi pronën e as që ka qenë ndonjëherë pronar legjitim (e cila i jep të drejtën e hyrjes në posedim). Me të njëjtin arsyetim, por me vendim tjetër Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore ka refuzuar kërkesën tjetër të ngjashme të paraqitur nga paraqitësi tjetër i kërkesës – K. B.

Me 26 tetor 2011, KKPK-ja në vendimin e tij KPCC/D/R/131/2011 e ka refuzuar kërkesën. KKPK-ja ka pranuar se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë ligjore se ai është pronar legjitim. Kontrata e prezentuar nga paraqitësi i kërkesës nuk ka mundur të verifikohet pozitivisht.

Me vendimin e njëjtë, KKPK-ja e ka refuzuar një kërkesë identike të një personi tjetër (K. B.), lidhur me të njëjtën banesë mbi bazën e njëjtë – nuk ka të dhënat të verifikueshme për posedimin e pretenduar apo për të drejtën pronësore që do t'i jepte të drejtën e hyrjes në posedim. Për sa i përket K. B., KKPK-ja ka pranuar që ai ishte në posedim për dy muaj pas përfundimit të konfliktit të banesës, që d.m.th deri me 20 gusht 1999, gjë që përjashton mundësinë që paraqitësi i kërkesës D. Z. ka qenë në posedim të banesës deri me 1 gusht 1999, siq ai pretendon.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 20 shkurt 2012. Me 16 mars 2012, ai ka paraqitur ankesë.

### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, Gjykatat nuk duhet të elaborojë rreth meritave të ankesë, përkatësisht meritave të vendimit të kundërshtuar pasi që ky i fundit është marrë në mungesë të juridiksionit. Kjo është në këtë mënyrë, sepse sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore **për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.**

Vetë paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se humbja e pronës kishte ndodhur me 1 gusht 1999. Nga të dhënat e disponuara në lëndë ky pohim duket shumë i pamundur. KKPK-ja ka konstatuar se personi tjetër K. B. ishte në posedim të banesës gjatë kësaj kohe, ose së paku deri me 20 gusht 1999. Për më shumë në lidhje me këtë nuk ka të dhëna nëse paraqitësi i kërkesës D. Z. kishte qenë ndonjëherë në posedim të pronës para kësaj kohe – para 20 qershorit 1999, të cilën kohë ai as që e ka pohuar.

Përveç kësaj dhe në kontekst të shume pretendimeve ekzistuese lidhur me këtë banesë, kërkesat për pronësi të D. Z. dhe K. B., të drejtat pronësore të kërkuara nga pala përgjegjëse në kërkesë M. K. dhe faktit se banesa e njëjtë ishte kërkuar pa sukses nga babai i D. Z., V.Z., në procedurën pranë KKPB-së, i vetmi konkludim logjik që mund të nxirret është se kontesti lidhur me pronën në fjalë as nuk rrjedh e as nuk është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me konfliktin e armatosur të 1998/1999.

Mbi bazën e kësaj duhet të pranohet se humbja e posedimit të pretenduar nuk ishte e lidhur me konfliktin e armatosur i cili kishte përfunduar me 20 qershor 1999.

Përderisa kërkesa është jashtë fushëveprimit të juridiksionit të AKP-së, KKPK-së nuk i është dashur të vendos për meritat e kërkesë por ta hedhë poshtë atë. Kjo nuk është bërë dhe KKPK-ja ka marrë një vendim të pavlefshëm i cili duhet të anulohet sipas argumentit të nenit 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas dispozitës ligjore të referuar, kur gjykata e shkallës së parë (në këtë rast është organ pothuajse gjyqësor) merr një vendim jashtë juridiksionit të saj, gjykata e shkallës së dytë duhet ta anulojë vendimin dhe ta hedhë poshtë kërkesën.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore zbatohen përputhshmërisht në procedurën pranë Gjykatës Supreme, sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Në mungesë të juridiksionit do të ishte e panevojshme që të elaborohet nëse kërkesa, ankesa dhe përgjigja në dy këto janë të bazuara në meritat e tyre. Për qartësim procedural, ankesa duhet të refuzohet.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për ushtrimin e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit për hedhjen e kërkesës (10.21, 10.12, 10.1 dhe 10.15 përshtatshëmrisht i UA 2008/2): duke pasur parasysh vlerën e pronës në fjalë e cila do të mund të kalkulohej si € 28912: € 194,56 (€ 50 + 0.5% e 28912) jo më shumë se € 30.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjykata vendos që në rastin tanishëm tarifatat gjyqësore duhet të paguhen nga pala ankuese brenda 90 (nëntëdhjetë). Neni 47.3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Philip Drake, Shef i Shkrimoreve pranë Asemblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it**